



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETEROR I ZGJEDHJEVE

Data: 27 Janar 2022

Nr: 23

VENDIM

**PËR PËRZGJEDHJEN E MONITORUESVE PËR ZGJEDHJET E PJESSHME TË ORGANEVE
TË QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 6 MARS 2022, PËR BASHKITË DURRËS, VORË,
RROGOZHINË, LUSHNJE, SHKODËR DHE DIBËR**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, udhëzimit nr. 01 datë 02.02.2021, “Për caktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit”, si dhe vendimit nr. 2, datë 21.01.2022, “Për caktimin e numrit të monitoruesve për zgjedhjet e pjesshme për organet e qeverisjes vendore të datës 6 mars 2022”,

VËREN:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në vlerësim të rëndësisë dhe transparencës së procesit, si dhe në përmbushje të detyrimit administrativ për njoftimin e palëve, ka bërë njoftim publik për pjesëmarrje në këtë procedurë për të gjithë aplikantët, duke i dhënë prioritet monitoruesve të cilët kanë qenë pjesë e procesit për Zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, për të qenë monitorues për zgjedhjet e pjesshme të organeve të qeverisjes vendore, të datës 6 mars 2022. Ky njoftim publik është realizuar nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të institucionit.

Pas njoftimit publik, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në zbatim të udhëzimit nr. 01, datë 02.02.2021, “Për caktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit”, kanë depozituar dokumentacionin 28 (njëzet e tetë) aplikant të interesuar për monitorues, si më poshtë vijon:

- 14 (katërmëdhjetë) aplikant kanë depozituar dokumentacionin për të qenë monitorues për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 mars 2022 për bashkinë Durrës;
- 1 (një) aplikant ka depozituar dokumentacionin për të qenë monitorues për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 mars 2022 për bashkinë Vorë;



- 1 (një) aplikant ka depozituar dokumentacionin për të qenë monitorues për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 mars 2022 për bashkinë Rrogozhinë;
- 5 (pesë) aplikant kanë depozituar dokumentacionin për të qenë monitorues për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 mars 2022 për bashkinë Shkodër;
- 2 (dy) aplikant kanë depozituar dokumentacionin për të qenë monitorues për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 mars 2022 për bashkinë Dibër;
- 5 (pesë) aplikant kanë depozituar dokumentacionin për të qenë monitorues për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 mars 2022 për bashkinë Lushnje.

Referuar vendimit nr. 2, datë 21.01.2022, “Për caktimin e numrit të monitoruesve për zgjedhjet e pjesshme për organet e qeverisjes vendore të datës 6 mars 2022”, nevojat për monitorues për bashkitë ku do të zhvillohen zgjedhjet e pjesshme të datës 6 mars 2022, janë si më poshtë vijon:

- Për bashkinë Durrës kërkohen 7 (shtatë) monitorues;
- Për bashkinë Vorë kërkohet 1 (një) monitorues;
- Për bashkinë Rrogozhinë kërkohet 1 (një) monitorues;
- Për bashkinë Shkodër kërkohen 5 (pesë) monitorues;
- Për bashkinë Dibër kërkohen 2 (dy) monitorues; dhe
- Për bashkinë Lushnje kërkohen 4 (katër) monitorues.

Të 28 (njëzet e tetë) aplikantët plotësojnë kriteret e përcaktuara të udhëzimit nr. 01, datë 02.02.2021, “Për caktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit”.

Për sa më sipër për bashkinë Durrës ka pasur 14 (katërmëdhjetë) aplikime dhe nga këto, 7 (shtatë) kanë qenë pjesë e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021 dhe duke u bazuar në vendimin nr. 2, datë 21.01.2022, “Për caktimin e numrit të monitoruesve për zgjedhjet e pjesshme për organet e qeverisjes vendore të datës 6 mars 2022”, numri që nevojitet për këtë bashki është 7 (shtatë) monitorues për këtë arsye janë përzgjedhur automatikisht.

Për bashkinë Vorë ka pasur vetëm 1 (një) aplikim dhe aplikanti ka qenë pjesë e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021, për këtë arsye ky aplikant u përzgjedh automatikisht.

Për bashkinë Rrogozhinë ka pasur vetëm 1 (një) aplikim dhe aplikanti ka qenë pjesë e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021, për këtë arsye ky aplikant u përzgjedh automatikisht.

Për bashkinë Shkodër ka pasur 5 (pesë) aplikimi ndër të cilët 3 (tre) nga aplikantët kanë qenë pjesë e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021, ndërsa 2 (dy) aplikant janë pa Certifikatë Vlerësimi, por duke u bazuar në vendimin nr. 2, datë 21.01.2022, “Për caktimin e numrit të monitoruesve për zgjedhjet e pjesshme për organet

e qeverisjes vendore të datës 6 mars 2022”, numri që nevojitet për këtë bashki është 5 (pesë) monitorues për këtë arsye janë përzgjedhur automatikisht.

Për bashkinë Dibër ka pasur 2 (dy) aplikime, por edhe pse nuk janë të pajisur me Certifikatë Vlerësimi duke u bazuar në vendimin nr. 2, datë 21.01.2022, “Për caktimin e numrit të monitoruesve për zgjedhjet e pjesshme për organet e qeverisjes vendore të datës 6 mars 2022”, numri që nevojitet për këtë bashki është 2 (dy) monitorues për këtë arsye janë përzgjedhur automatikisht.

Për bashkinë Lushnje ka pasur 5 (pesë) aplikime dhe nga këto 4 (katër) aplikant kanë qenë pjesë e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021 dhe duke u bazuar në vendimin nr. 2, datë 21.01.2022, “Për caktimin e numrit të monitoruesve për zgjedhjet e pjesshme për organet e qeverisjes vendore të datës 6 mars 2022”, numri që nevojitet për këtë bashki është 4 (katër) monitorues për këtë arsye janë përzgjedhur automatikisht.

PËR KËTO ARSYE:

Referuar nenit 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, udhëzimit nr. 01 datë 02.02.2021, “Për caktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit”, si dhe vendimit nr. 2, datë 21.01.2022, “Për caktimin e numrit të monitoruesve për zgjedhjet e pjesshme për organet e qeverisjes vendore të datës 6 mars 2022”,

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën e monitoruesve për Bashkinë Durrës, të cilët do të kryejnë monitorimin për zgjedhjet e pjesshme të organeve të qeverisjes vendore, si më poshtë vijon:
 - 1) Silvana Basha;
 - 2) Geis Naço (Bega);
 - 3) Anxhela Zojaku;
 - 4) Ergys Xibinaku;
 - 5) Klajdi Pulaj;
 - 6) Nensi Dragoti;
 - 7) Rovena Mullaj.
2. Të miratojë listën e monitoruesve për Bashkinë Shkodër, të cilët do të kryejnë monitorimin për zgjedhjet e pjesshme të organeve të qeverisjes vendore, si më poshtë vijon:
 - 1) Besmir Murati;
 - 2) Paulin Peci;



- 3) Oltjon Çoba;
 - 4) Marjan Toma;
 - 5) Etleva Ferizi.
3. Të miratojë listën e monitoruesve për Bashkinë Lushnje, të cilët do të kryejnë monitorimin për zgjedhjet e pjesshme të organeve të qeverisjes vendore, si më poshtë vijon:
- 1) Albana Cika;
 - 2) Armand Kallaji;
 - 3) Gleni Bego;
 - 4) Dafina Tafa.
4. Të miratojë listën e monitoruesve për Bashkinë Dibër, të cilët do të kryejnë monitorimin për zgjedhjet e pjesshme të organeve të qeverisjes vendore, si më poshtë vijon:
- 1) Gerond Shehu;
 - 2) Kesiana Zeneli.
5. Të miratojë monitoruesin për Bashkinë Vorë, i cili do të kryejë monitorimin për zgjedhjet e pjesshme të organeve të qeverisjes vendore, si më poshtë vijon:
- 1) Ditjon Murati.
6. Të miratojë monitoruesin për Bashkinë Rrogozhinë, i cili do të kryejë monitorimin për zgjedhjet e pjesshme të organeve të qeverisjes vendore, si më poshtë vijon:
- 1) Anastas Pjetri.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

